



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.197, datë 12.07.2022

PËR  
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zoti Lazër Çardaku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Zoti Lazër Çardaku, do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër nga data 17.07.2022 – 16.10.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Lazër Çardaku do të paguhet me pagën e pozicionit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Lazër Çardaku, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 12.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

  
KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Ludovik Dodaj

ANËTAR  
Mirela Bogdani